



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	19.02.2020
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-60

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

**Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri**

Prizren, më 18.02.2020

Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-135 Për Veprimtari Kërkimore – Shkencore, duke u bazuar në nenin 160 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621 të datës 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më, 11.02.2020 mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Strategjia për Veprimtari Kërkimore - Shkencore 2020 - 2024.
- II. Strategjia për Veprimtari Kërkimore - Shkencore 2020 - 2024, do të rishikohet çdo vit, Këshilli Drejtues do të konsultohet me Ministrinë përkitazi me përputhjen e objektivave dhe të planeve të veta me Strategjinë shtetërore për arsimin e lartë dhe të burimeve që do të jenë në dispozicion nga Ministria.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë Strategjia e sipërshënuar.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Strategjia për Veprimtari Kërkimore - Shkencore 2020 – 2024 e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren është rezultat i një procesi me pjesëmarrje të gjerë të ekspertëve nga fusha të ndryshme akademike dhe është hartuar duke u bazuar në Programin Kombëtar të Shkencës si dokument bazë që ofron një kornizë konceptuale për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore në Kosovë, duke përcaktuar prioritetet kërkimore, objektivat zhvillimore, masat për arritjen e tyre, si dhe koston e zbatimit të Programit.

Të bindur që Strategjia për Veprimtari Kërkimore - Shkencore 2020 – 2024 do të shërbejë si udhërfyes për mbështetjen dhe organizimin e punës kërkimore shkencore në Universitet, Këshilli Drejtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menxhmentit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrës Ligjore;
- Arkivit.

